



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2024:322945
Datë: 03.02.2025
Numri i dokumentit: 06792799

Pml.nr.48/2025

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Afrim Shala kryetar, Agim Maliqi dhe Valdete Daka, anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Qefsere Berisha, procesmbajtëse, në çështjen penale ndaj të pandehurit F. I., për shkak të veprës penale “Vrasje e rëndë” në tentativë nga neni 173, paragrafi 1 nën-paragrafi 1.10 lidhur me nenin 28 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur lidhur me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të të pandehurit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj - Departamenti i Krimeve të Rënda, 2024:345060, datë 10.12.2024 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti i Krimeve të Rënda PN.1.nr.1176/2024, datë 27.12.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më 31.01.2025, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësit të të pandehurit F. I. e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj - Departamenti i Krimeve të Rënda, 2024:345060, datë 10.12.2024 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN.1.nr.1176/2024, datë 27.12.2024.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Ferizaj - Departamenti i Krimeve të Rënda, me aktvendimin 2024:345060 e datës 10.12.2024, të pandehurit F. I., për shkak të veprës penale “Vrasje e rëndë” në tentativë nga neni 173, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.10 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, ia ka vazhduar masën e paraburgimit në kohëzgjatje prej 2 (dy) muajve, e cila masë do t’i zgjasë nga data 10.12.2024 deri më datën 09.02.2025. Masa e paraburgimit i është vazhduar në bazë të nenit 188, paragrafi 1 lidhur me nenin 184, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1. dhe 1.2, pikat 1.2.2, dhe 1.2.3. të Kodit të Procedurës Penale (KPP).

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktvendimin PN.1.nr.1176/2024 të datës 27.11.2024, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të të pandehurit dhe e ka vërtetuar aktvendimin e shkallës së parë.

Kundër këtyre aktvendimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka ushtruar mbrojtësi i të pandehurit F. I., avokati Arbër Halili, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384, paragrafi, nën-paragrafi 1.10. të KPP-së dhe për shkak të shkeljes së ligjit penal nga neni 385, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.2. të KPP-së, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës të ndryshojë aktvendimet e kundërshtuara ashtu që të pandehurit t’i ndërpritet masa e paraburgimit dhe kjo masë t’i zëvendësohet me masën e arrestit shtëpiak ose aktvendimet të anulohen dhe çështja të kthehet në rivendosje.

Kryeprokurori i Shtetit, me shkresën KMLP.III.nr.21/2025, datë 30.01.2025, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të pandehurit të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës pasi i shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435, paragrafi 1 lidhur me nenin 436, paragrafi 1 të KPP-së, vlerësoi pretendimet në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë dhe gjeti se:

- kërkesa është e pabazuar.

Në kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë, mbrojtësi i të pandehurit thekson se aktvendimet e kundërshtuara janë përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale për shkak se gjykatat janë bazuar në shkaqe të njëjta me të cilat e kanë caktuar masën e paraburgimit. Prokuroria nuk ka dhënë fakte të mbështetura në prova të pakontestueshme se përse ka arsye për të besuar se i pandehuri do të ndikojë në dëshmitarë nëse ai gjendet nën mesën e arrestit shtëpiak, për faktin se ai as nuk i njeh këta dëshmitarë potencial. Shkelja e ligjit penal konsiston se në rastin konkret ka rrethana që e përjashtojnë të pandehurin nga përgjegjësia penale pasi që edhe gjatë qëndrimit në vuajtje të dënimit ka qenë me probleme psikike dhe ka marrë terapi për këtë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimet e mësipërme janë të pabazuara, ngase ka bazë ligjore për vazhdimin e paraburgimit konform dispozitës së nenit 184, paragrafi 1. nën-paragrafi 1.1. e 1.2. pika 1.2.2. të KPP-së, ngase janë katër persona të dëmtuar e të cilët potencialisht mund të dëgjohen si dëshmitarë dhe se ekziston rreziku i ndikimit në ta e në këtë mënyrë do ta pamundësoj zhvillimin e rregullt të procedurës penale.

Po ashtu, kjo Gjykatë vlerëson se ka bazë ligjore për vazhdimin e paraburgimit konform nenit 184, paragrafi 1 nën-paragrafi 1.1. e 1.2. pika 1.2.3. të KPP-së, duke pasur parasysh peshën e veprës penale, mënyra dhe rrethanat në të cilat dyshohet se është kryer vepra penale, sidomos faktin se bëhet fjalë edhe për fëmijë të lënduar, si dhe bazuar në karakteristikat personale të të pandehurit i cili më parë ka qenë i gjykuar dhe dënuar për vepra penale, respektivisht ka mbajtur dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 16 vite e 10 muaj për vepër penale “Vrasja e rëndë” si dhe dënimin me burgim për veprën penale Kanosja, po ashtu edhe fakti se çështja është në fazën e shqyrtimit gjyqësorë, janë rrethana të cilat tregojnë se po të gjendet i pandehuri në liri ekziston rreziku se do të mund të përsëris veprën penale të natyrës së njëjtë apo të ngjashme, andaj vazhdimi i paraburgimit është i arsyeshëm për rrjedhën normale të procedurës penale.

Sa i përket pretendimeve të mbrojtësit të të pandehurit lidhur me gjendjen shëndetësore të të pandehurit, në shkresat e lëndës është kërkesa; PP/I.nr.125/2024, datë 13.12.2024, Kërkesë për ekzaminimin psikiatrik dhe psikologjik, e ushtruar nga prokuroria, dhe se pritët që nga konstatimet dhe mendimet që do të dalin nga ky ekzaminim të veprohet më tej.

Andaj nga arsyet e mësipërme, kjo Gjykatë vlerëson se në rastin konkret nuk ka shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, sepse si gjykata e shkallës së parë e po ashtu edhe ajo e shkallës së dytë kanë bërë vlerësimin dhe arsyetimin e duhur si dhe në bazë të vlerësimit të tillë kanë nxjerrë aktvendimet duke dhënë edhe arsyet të mjaftueshme, ndërsa masat tjera alternative – arresti shtëpiak, janë të pamjaftueshme për sigurimin e prezencës të pandehurit në procedurë dhe sigurimin e rrjedhës normale të procedurës penale.

Nga sa u parashtrua më lartë dhe në kuptim të nenit 437 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË
Pml.nr.48/2025, më 31.01.2025.

Bashkëpunëtorja profesionale,
Qefsere Berisha

Kryetari i kolegjit,
Afrim Shala